



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.961/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit A...T... Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Hani i Elezit, ..., p.nr., kundër debitorit G...A... Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Fushë Kosovë, ..., p.nr., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 245/21, i lejuar me datë 0309.2021, nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit G...A... Sh.P.K., me numër unik identifikues ..., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 245/2021 i lejuar më datë 03.09.2021, nga Përmbartuesi Privat Eminie Sherifi-Lubeniqi, për pjesën e detyrimit në shumë prej EUR 450.00 (katërqind e pesëdhjetë Euro), sipas Faturës Nr: 20-SHV04-001-993, të datës 16.11.2020.

- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit G...A... Sh.P.K., me numër unik identifikues ..., për shumën e borxhit në lartësi prej EUR 3,675.00 (tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë Euro) dhe për këtë pjesë Urdhri Përmbartimor P.nr. 245/2021, i lejuar më datë 03.09.2021, nga Përmbartuesi Privat Eminie Sherifi-Lubeniqi
MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, faturave nr. 20-SHV04-001-427, e datës 07.07.2020, faturës nr. 20-SHV04-001-542, e datës 22.07.2020, faturës nr. 20-SHV04-001-881, e datës 25.10.2020, faturës nr. 20-SHV04-001-993, e datës 16.11.2020, faturës nr. 21-SHV04-001-62, e datës 22.01.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-63, e datës 22.01.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-229, e datës 03.03.2021, Faturës nr. 21-SHV04-001-413, e datës 12.04.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-548, e datës 11.05.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-624, e datës 01.06.2021, si dhe faturës nr. 21-SHV04-001-778, e datës 08.07.2021, ka lejuar urdhrin përmbarimor P.nr. 245/2021, të datës 03.09.2021, me të cilin është urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri ti paguaj kreditorit shumën prej EUR 4,125.00, me kamatë ligjore prej 8% nga data e inicimit të procedurës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për përmbarim me arsyetim se dokumentet e besueshme mbi të cilat është mbështetur urdhri për lejimin e përmbarimit nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë. Ka shtuar se propozimi për përmbarim i kreditorit është i pabazë juridike dhe i jashtëligjshëm pasi që, me përjashtim të disa faturave të cilat janë të rregullta, pjesa tjetër e faturave nuk janë pranuar, nënshkruar apo vulosur nga debitori si dhe nuk kanë adresë të njejtë. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të abrogohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, ka theksuar se debitori ka kërkuar ofertë për transport ndërsa kreditori ka ofruar shërbime të transportit për debitorin, mirëpo që ky i fundit nuk i ka përmbushur obligimet financiare ndaj kreditorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.245/21, i datës 03.09.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr: 20-SHV04-001-993, e datës 16.11.2020, për shkak se kjo faturë nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së. Kjo, për arsye se nga provat që gjenden në shkresa të lëndës, nuk mund të vërtetohet se kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë me të cilën dëshmohet se e njëjta i është dorëzuar debitori. Prandaj, fatura e lëshuar nga kreditori mirëpo e papranuar nga ana e debitorit, si e tillë, paraqet dokument të njëanshëm dhe nuk është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke refuzuar prapësimin për pjesën e borxhit në lartësi prej EUR 3,675.00 dhe duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor për këtë pjesë, për arsye se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht faturave nr. 20-SHV04-001-427, e datës 07.07.2020, faturës nr. 20-SHV04-001-542, e datës 22.07.2020, faturës nr. 20-SHV04-001-881, e datës 25.10.2020, faturës nr. 21-SHV04-001-62, e datës 22.01.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-63, e datës 22.01.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-229, e datës 03.03.2021, Faturës nr. 21-SHV04-001-413, e datës 12.04.2021, faturës nr. 21-SHV04-001-548, e datës 11.05.2021, faturës

nr. 21-SHV04-001-624, e datës 01.06.2021, si dhe faturës nr. 21-SHV04-001-778, e datës 08.07.2021, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 paragrafi1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 961/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.